

SUGJERIME PËR PËRMIRËSIMIN E KONTROLLIT TATIMOR

**Këshilli i Investimeve
5 Tetor 2015, Tiranë**

Diana LEKA, lekad@investment.com.al

Përmbajtja

- Konteksti
- Metodologjia
- Gjetjet dhe Rekomandimet

I. KONTEKSTI



1.1 VLERËSIME NGA BIZNESI PËR KONTROLLIN TATIMOR

- ☐ Ndryshime të shpeshta të legjislacionit tatimor
- ☐ Vetëm gjysma e kontrolleve bëhen për arsye legjitime
- ☐ Gjobat janë një lojë rryshfetestesh dhe lidhjesh politike
- ☐ Shqiperia duhet të adoptojë procedura sa më “robuste” nga ana administrative VAT dhe IT
- ☐ Paqartësi e ligjit & procedura tatimore të ndërlikuara
- ☐ Kur apeloher bëhen më shumë kontrolle
- ☐ Mesatarisht një subjekt bën 34 pagesa, harxhon 357 orë në vit për dokumentacion/pagesa taksash.

FIAA

DIHA

BE

DHTI

BB/
IFC

OBJEKTI I ANALIZËS

Të vlerësojë shqetësimet kryesore të biznesit mbi procesin e kontrollit tatimor, të evidentojë problematikat kryesore dhe të japë rekomandime për vendimmarrjen në kontekstin e një marrëdhënie konstruktive biznes – qeveri.

II. Metoda – Profilizim i Problemeve

Desk research

- Kuadri ligjor i tatimeve;
- Anketa e FIAA-s mbi “Klimën e Biznesit në Shqipëri” (2015), IFC-së mbi “Koston e Pajtueshmërisë me Taksat” (2013), Shoqatës së Turizmit;
- Raporte të OECD-së dhe FMN-së, Bankës Botërore, BERZH, etc.

Takime

- Zyrtarë të Ministrisë së Financave dhe Tatimeve;
- Perfaqësues të Shoqatave të Biznesit si FIAA, AAB, ATA, Dhoma e Tregtise dhe Industrisë së Tiranës;
- Fokus grup me 10 ekspertë fiskale.

Anketa

- Anonime & online në faqen e Këshillit të Investimeve, shpërndarë gjithashtu në bashkëpunim me shoqatat e biznesit si FIAA, AAB, ATA, DHTI Tiranë, DIHA;
- Pjesëmarrëse 110 kompani, 78% kompani të mesme & mëdha, 22% kompani të huaja;
- Sektorët më përfaqësues janë: Shërbimet (32%), Turizmi (24%) dhe Industria (22%).

III. GJETJET KRYESORE



KONSIDERATA



LIGJORE



ADMINISTRATIVE





TRANSPARENCË

3.1 KUADRI LIGJOR – PROÇEDURAT E KONTROLLIT TATIMOR

GJETJE	REKOMANDIME
1. PËRZGJEDHJA E BIZNESEVE Jo transparente, lë vënd për interpretime abuzive, numër i madh kontrollesh	KRITERET E RISKUT - Specifikimi i kriterëve bazë të riskut në Ligjin 9920 - Detajimi i kriterëve sipas industrisë & madhësisë së bizneseve në Udhëzimin Nr 24 dhe aktet e brendshme - Publikim i kriterëve bazë të identifikimit të riskut dhe minimizimi i ndryshimeve të tyre në sistemin elektronik të riskut - Përgatitja, adoptimi & publikim <u>në afat të mesëm</u> të 90% të përzgjedhjes nga sistemi me bazë risku për të gjitha llojet e kontrolleve, aktualisht ka filluar TVSH.
2. AFATI I NJOFTIMIT Mungon në ligj afati i njoftimit të tatimpaguesit për kontrollin e plotë	LIGJI 9920 “MBI PROÇEDURAT TATIMORE” Të përcaktohet qartë një afat kohor prej 10 ditë kalendarike për njoftimin paraprak të tatimpaguesve, përveç rasteve <i>të verifikimit në terren.</i>
3. ROLI I KUFIZUAR I AVOKATIT TË TATIMPAGUESVE	AVOKATI I TATIMPAGUESVE Zgjerimi i rolit të AT në Kontrollin Tatimor veçanërisht në <u>proçedurat e ri-kontrollit</u>; Ri-strukturimi i Zyrës së AT për të rritur pavarësinë e tij në fushën e bashkëveprimit dhe partneritetit me tatimpaguesit (Ligji 9920).

LLOJI & KOHËZGJATJA E KONTROLLIT TË FUNDIT 2013-2015 PËR BIZNESIN E MADH




3.1 KUADRI LIGJOR – APELIMI TATIMOR


GJETJE	REKOMANDIME
1. AKSESI NË APELIM Procedurat e apelitit tatimor perceptohen të vështira dhe jo efikase	LIGJI 9920 “MBI PROÇEDURAT TATIMORE” Përveç “<i>Garancisë Bankare</i>” sikurse parashikuar nga Ligji, tatimpaguesi duhet të legjitimohet për të filluar procedurën e Apelitit, duke paguar paraprakisht vetëm 50% të detyrimit tatimor, nga 100% që është aktualisht (<i>ref. Neni 107</i>).
2. ANKIMIMI I VENDIMEVE TË APELIMIT Ankimi nga Drejtoritë Rajonale të Tatimeve i vendimeve të Drejtorisë së Apelitit Tatimor është jo eficient dhe penalizuese për bizneset	LIGJI 9920 “MBI PROÇEDURAT TATIMORE” - Vendimet e Drejtorisë së Apelitit të jenë automatikisht të detyrueshme për Drejtoritë Rajonale të Tatimeve (<i>ref. Neni 109/3</i>); - Të konsiderohet rritja e pavarësisë së Drejtorisë së Apelitit Tatimor dhe mbështetja me burimet e nevojshme buxhetore.

EFEKTIVITETI I APELIMIT TATIMOR - VLERËSIM NGA BIZNESI I MADH

A keni ndërmarrë gjatë 3 viteve
të fundit një proces apelimi
tatimor?



Efektiviteti i procedures




3.2 ADMINISTRATA TATIMORE


GJETJE	REKOMANDIME
KAPACITETET E INSPEKTORËVE TATIMORË Vlerësime shqetësuese për: - Etikën & Komunikimin - Kompetencat & Specializimin - Mbështetja Logjistike	RRITJA E KAPACITETEVE TË INSPEKTORËVE - Emërimet të bëhen mbi profilin e tatimpaguesit dhe sipas specifikave sektoriale; - Paketat motivuese për inspektorët me rezultate (etikën, komunikimin, aftësitë profesionale dhe jo vetëm gjrobat); -Trajtime të specializuara në fushën e tatimeve dhe kontabilitetit; - Vlerësim online nga Biznesi mbi kontrollin tatimor.
INTERPRETIME TË NDRYSHME TË LEGJISLACIONIT - Papajtueshmëri në interpretimet ligjore për <u>praktika të ngjashme</u>; - Referenca ligjore e pashoqëruar me interpretim për rastet konkrete të paraqitura për shqyrtim.	PËRMIRËSIMI I ANALIZËS LIGJORE - DPT dhe DAT të rrisin kapacitetet në analizën ligjore dhe të unifikojnë praktikat e tyre; - DPT të përgatisë dhe të publikojë në faqen e saj zyrtare në internet Komentarin Vjetor të Çështjeve të trajtuara.

Vlerësim mbi Kapacitetet e Inspektorit Tatimor


Biznesi i Madh




Sipërmarresit e Huaj




Shërbimet



Tregti




Vlerësim mbi Qartësinë e Shpjegimeve të Legjislacionit Ofruar nga Administrata Tatimore



3.3 TRANSPARENCA DHE NDËRGJEGJËSIMI

GJETJE	REKOMANDIME
1. AKSESI NË INFORMACION Vështirësi në gjetjen e të dhënave dhe interpretimeve të nevojshme në faqen e internetit të <i>Tatime.gov.al</i>	RRITJA E TRANSPARENCËS - Publikimi i raporteve vjetore të DPT dhe DAT. Vendimet e DAT duhet të publikohen në mënyrë sistematike - Faqja zyrtare në internet akses 100% edhe në gjuhën angleze - Manuale të thjeshta dhe sesione informuese për bizneset e vogla dhe të mesme.
2. NDRYSHIME TË SHPESHTA NË LEGJISLACION Ligji Nr.9920 “Për Proçedurat Tatimore”, është ndryshuar 11 herë, ndërkohë që ndryshimi i tij i 12-të është aprovuar së fundmi nga Këshilli i Ministrave dhe shumë shpejt do të hyjë në fuqi.	QËNDRUESHMËRI E LEGJISLACIONIT - Konsultime publike në mënyrë që ndryshimet të kuptohen paraprakisht nga biznesi - Zhvillimi i një programi vjetor komunikimi me shoqatat e biznesit sipas sektorëve mbi problematikat e legjislacionit dhe proçedurat tatimore - DPT të konsiderojë zhvillimin e një proçedure për njoftimin elektronik të tatimpaguesve (p.sh nëpërmjet pop-up) mbi ndryshimet në legjislacionin tatimor.

VLERËSIM I BIZNESIT MBI FAKTORËT QË INFLUENCOJNË ZBATIMIN E DUHUR TË LEGJISLACIONIT TATIMOR



- 1 Specifikimi dhe publikim i kritereve bazë të riskut sipas industrisë dhe madhësisë së biznesit.
- 2 Përgatitja, adoptimi dhe publikim në afat të mesëm në 90% të përzgjedhjes nga sistemi me bazë risku për të gjitha llojet e kontroleve.
- 3 Në ligj të përcaktohet qartë një afat kohor minimal prej 10 ditë kalendarike për njoftimin paraprak të tatimpaguesve, përveç rasteve të inspektimit në terren.
- 4 Zgjerimi i rolit të AT në Auditimin Tatimor veçanërisht në procedurat ri-kontrollit.
- 5 Ri-strukturimi i Zyrës së AT për të rritur pavarësinë e tij në fushën e bashkëveprimit dhe partneritetit me tatimpaguesit. Konsiderimi i ngritjes së një strukture të pavarur (ombudsman i biznesit).
- 6 Përveç “Garancisë Bankare” sikurse parashikuar nga Ligji, tatimpaguesi duhet të legjitimohet për të filluar procedurën e Apelimit, duke paguar vetëm 50% të detyrimit tatimor.
- 7 Vendimet e Apelimit të jenë automatikisht të detyrueshme për Drejtoritë Rajonale të Tatimeve.
- 8 Të konsiderohet në afat të mesëm rritja e pavarësisë së Drejtorisë së Apelimit.
- 9 Emërimet të bëhen mbi profilin e tatimpaguesit dhe sipas specifikave sektoriale. Trajnime të specializuara në fushën e tatimeve dhe kontabilitetit.

- 10 Paketat stimuluese për motivimin dhe vlerësimi jo vetëm mbi bazën e “gjobave” por edhe konsiderimi i etikes, komunikimit, kapaciteteve profesionale.
Vlerësim nga Biznesi mbi kontrollin tatimor online.
- 11 DPT dhe DAT të rrisin kapacitetet në analizën ligjore dhe të unifikojnë praktikat e tyre.
- 12 DPT të përgatisë dhe të publikojë në faqen e saj zyrtare në internet Komentarin Vjetor të Çështjeve të trajtuara.
- 13 Publikimi i raporteve vjetore të DPT dhe DAT. Vendimet e DAT duhet të publikohen në mënyrë sistematike. Faqja zyrtare e DPT akses 100% edhe në gjuhën angleze.
- 14 Manuale të thjeshta dhe sesione informuese për bizneset e vogla dhe të mesme.
- 15 Konsultimeve publike në mënyrë që ndryshimet të kuptohen paraprakisht nga biznesi. Zhvillimi i një programi vjetor komunikimi me shoqatat e biznesit sipas sektorëve mbi problematikat e legjislacionit dhe procedurat tatimore.
- 16 DPT të konsiderojë zhvillimin e një procedure për njoftimin elektronik të tatimpaguesve (p.sh nëpërmjet pop-up) mbi ndryshimet në legjislacionin tatimor.

FALEMINDERIT